

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	PD zgjeron sulmin ndaj SPAK: Pas Altin Dumanit, në shënjestër edhe Klodian Braho
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/pd-zgjeron-in-ndaj-spak-pas-altin-dumanit-ne-shenjes-ter-edhe-klodia-i588876
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 08:10:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 09:00:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	baef9d72d5d2ce317e4ed3f5f45a28fc57dc53755dc455f4f5ae7151c1f0800b
TEKSTI	e56dae12721f465ec5945ffd13b5f51a4e40b64aeccd2cc382d214af87c74033
PAMJA	33fa269e0ac1286d0e4fb243921e8dd5690e35b5e42e0662b2a5e5d8867e00b7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1395ee6decc4a2c4162189d6cd733cfda269b9385ac2e4ddf9bcd170ea7b7d7d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f736abde33fe298fdab4b0ac01389ddc82e49c4df4ee1e7f323305e5a671536d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1395ee6decc4a2c4162189d6cd733cfda269b9385ac2e4ddf9bcd170ea7b7d7d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by



English



ie Hoxha takon kreun e Komisionit per Çeshtjet e BE-se ne Bundestag: Gjermania mbeshtet rrugetimin evropian te ShqiperiseSondazhi AIM: Kur ka qene me problematik fundit

PD zgjeron sulmin ndaj SPAK: Pas Altin Dumanit, në shënjestër edhe Klodian Braho



28 Shtator 2026, 11:00Politika TEMA



Partia Demokratike ka ashpërsuar tonet ndaj SPAK-ut, duke mos e kufizuar më sulmin vetëm te drejtuesi i institucionit, Altin Dumani. Këtë herë në shënjestër është vendosur edhe prokurori Klodian Braho, i përmendur nga deputetja demokrate Denisa Vata në lidhje me dosjen 184.

Në një lidhje direkte për A2 CNN, Vata deklaroi se nuk mund të pritët drejtësi nga SPAK për çështjen e Vlora Hysenit, duke e lidhur këtë me rolin e Klodian Brahos në hetimet e mëparshme për krimet zgjedhore.

"Këto denoncime që sot dalin, Sali Berisha i ka bërë në vitin 2023. Sali Berisha e ka denoncuar Vlorë Hysenin kur ai ishte në arrest shtëpie, pas një dosjeje të fabrikuar nga Edi Rama, Yuri Kim dhe Altin Dumani", u shpreh Vata.

Deputetja demokrate shkoi më tej, duke akuzuar drejtpërdrejt prokurorin Braho për mënyrën se si është trajtuar dosja 184, një nga dosjet më të përfolura të krimeve zgjedhore në vend.

"Si mundet të prisni një hetim nga SPAK-u kur aty është Klodian Braho? Klodian Braho është prokurori i dosjes 184, dosjes më të rëndë të krimeve zgjedhore, ku ajo u nda nga grup i strukturuar kriminal pikërisht nga zoti Braho", tha Vata.

Sipas saj, edhe prokurori tjetër i përmendur në këtë çështje, Vladimir Mara, nuk mund të shihet i shkëputur nga hija e dosjes 184, për shkak të lidhjeve familjare që, sipas Vatës, dalin në përgjimet e kësaj dosjeje.

"Dhe zoti Mara, që ishte pjesë e kësaj dosjeje, pasi kunati i tij del në përgjimet e gjykatës për dosjen 184. Po pse, këta do ta bëjnë drejtësinë?", deklaroi deputetja e PD-së.

Deklarata e Vatës vjen pas sulmeve të përsëritura të Sali Berishës ndaj SPAK-ut dhe Altin Dumanit, duke treguar se linja politike e opozitës po zgjerohet tashmë edhe ndaj prokurorëve të veçantë të institucionit. Në qendër mbetet pretendimi i PD-së se dosjet e mëdha politike dhe zgjedhore nuk janë hetuar deri në fund, ndërsa çështja Hyseni po përdoret si provë e radhës për të vënë në pikëpyetje besueshmërinë e SPAK-ut.



I ini një Përrnininie

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Integrimi i Shqipërisë në BE, sot konferencë ndërparlamentare në Tiranë! Marrin pjesë Rama dhe përfaqësues të parlamenteve europiane](#)

[VIDEO/ Rama mbërrin në Pallatin e Brigadave, fillon mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare](#)

08:56 Politika / 4 komente

["Nuk kam gjetur personazh të tillë që..." - Ali Aliu rrëfen bisedën me Berishën për Azem Hajdarin: Më tha "mos ma përmend atë idiot!"](#)

21:40 Politika / 36 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.